

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN - Departamenti i Përgjithshëm, përmes gjykatëses së vetme gjykuese, Luljete Shabani, me praktikanten Edona Selimi, në lëndën penale kundër të akuzuarit B.H. nga ..., për veprën penale **Asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë nga neni 333 paragrafi 1 i KPRK-së**, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan - Departamenti i Përgjithshëm, PP.II. nr. 1803/16, të datës 21.11.2016, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor dhe publik, më datën 23.05.2018, bie dhe në prezencë të palëve mori dhe shpalli, ndërsa më 24.05.2018 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari B.H., nga babai I. dhe nëna Z., e lindur S., i lindur më datë ... në ..., ku edhe jeton, ne Rr. “ ... ” rr.nr. ... i pa martuar, ka te kryer shkollen e mesme, i pa punë, i gjendjes se dobet ekonomike, Shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i pa dënuar më parë dhe nuk zhvillohet procedurë tjetër penale ndaj tij,

Ë S H T Ë F A J T O R

Sepse, më datë 28.09.2016, rreth orës 10:00 min. në lagjen “ ... ”, Rr. “ ... ”, ne ..., i pandehuri me dashje ka demtuar tre orman te njehsoreve elektrik, pronë e KEDS-it, me arsytim se, ne afersi te shtylles ku jane vendosur keta orman ka per qellim t'i hapë dyert e hyrjes se oborrit, duke i shkaktuar te demtuares, dem ne shume te papercaktuar,

-me çka ka kryer veprën penale **Asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë nga neni 333 paragrafi 1 i KPRK-së**, andaj, Gjykata, në bazë të dispozitave të neneve 7, 17, 21, 51, 73, 114 të KPRK-së dhe nenit 365, 453 dhe 463 të KPPRK-së,

E G J Y K O N
ME DËNIM ME KUSHT

Dënim Burgu në kohëzgjatje prej 3 (tre) muajsh, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari në kohën prej 1 (një) viti, nuk kryen vepër tjetër penale, në të kundërtën gjykata dënimin me kusht do ta revokojë.

Obligohet i akuzuari që të paguaj **paushallin gjyqësor** në shumë prej 15 (pesëmbëdhjetë) €, si dhe shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë përfundimtare të Gjykatës, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Pala e dëmtuar, **udhëzohet në kontest juridiko-civil**, për realizimin e kërkesës pasurore juridike.

A r s y e t i m

*Prokuroria Themelore në Gjiilan, Departamenti i Përgjithshëm, ka paraqitur Aktakuzë PP. II nr. 1803/2016, të datës 21.11.2016, kundër të akuzuarit B.H., për shkak të veprës penale **Asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë nga neni 333 paragrafi 1 i KPRK-së** dhe ka kërkuar që i akuzuari të shpallet fajtor dhe të dënohet me dënim meritor sipas ligjit.*

Prokurorja shtetit, Rozelida Manastiri, në fjalën përfundimtare deklaroi se në shqyrtimin e sotëm fillestar, i akuzuari B.H., e pranoi fajësinë për kryerjen e veprës penale e cila i vihet në barrë, i akuzuari fajësinë e pranoi me vetëdije të plotë dhe vullnet të lirë, pasi që nga ana e gjykatës u njoftua lidhur me favoret dhe pasojat e pranimit të fajësisë, me pranimin e fajësisë u vërtetua në tërësi gjendja faktike, ashtu siç është përshkruar në dispozitivin e aktakuzës lëndore, kështu që mbetet pranë aktakuzës dhe propozimeve të cilat e njëjta i përmban dhe kërkon nga gjykata që të akuzuarin ta shpallë fajtor dhe t'ia shqiptojë sanksionin penal konform dispozitave ligjore.

I akuzuari B.H., në fjalën përfundimtare deklaroi se është penduar për kryerjen e kësaj vepre, i vie keq, premton se në të ardhmen nuk do ta përsërisë këtë vepër, andaj, kërkon nga gjykata që t'ia shqiptojë një dënim sa më të butë që është e mundur.

Me rastin e caktimit dhe llojin e lartësisë së dënimit, Gjykata pati parasysh rrethanat e parapara me nenin 73 të KPRK-së dhe si rrethanë lehtësuese gjeti se i akuzuari pati sjellje korrekte në Gjykatë, se është penduar për veprën në fjalë, ndërsa, si rrethanë rënduese, mori shkallën e përgjegjësisë penale dhe rrezikshmërinë shoqërore të veprës penale, me bindje se edhe me një dënim të tillë do të arrihet qëllimi i dënimit si në kuptim të nenit 41 të KPRK-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale është i bazuar në nenin 453 të KPRK-së.

Nga të cekurat më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM
P.nr. 1392/16, më datë 24.05.2018**

Praktikantja,
Edona Selimi

Gjykatësja e vetme gjykuese,
Luljete Shabani

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa Gjykatës së Apelit në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të të njëjtit. Ankesa dorëzohet në dy ekzemplarë, përmes kësaj Gjykate.